Ambasadori dhe ministri për kulturë nënshkruajnë grantin AFCP

Të mërkurën, me 19 shtator, ambasadori i Shteteve të Bashkuara Paul.D.Wohlers dhe ministri për kulturë i Maqedonisë Elizabeta Kançeska Milevska nënshkruan marrëveshje për grant me vlerë prej $98,900 për ruajtjen e bujtinës të shekullit XVII në manastirin Shën Arhangjeli dhe Mikeli afër fshatit Kuçevishtë në Shkup. Ky është granti i njëmbëdhjetë me rradhë për mbrojtjen e trashëgimisë kulturore të Maqedonisë nëpërmjet Fondit të Ambasadorit për mbrojtje kulturore, program i finansuar nga Stejt Departmanti i Shteteve të Bashkuara.